

PËRMIRËSIMI I KONTRIBUTIT KOMBËTAR TË PËRCAKTUAR (KKP) EKZISTUES

Konteksti

Për të avancuar zbatimin e politikave dhe masave kombëtare të zbutjes dhe përshtatjes klimatike, Shqipëria duhet të zhvillojë kapacitete institucionale të mjaftueshme dhe sisteme dhe korniza strategjike të përshtatshme. Ky projekt i dha Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit rekomandime politikash dhe masash për përmirësimin e KKP-së ekzistuese, në përputhje me kërkesat e UNFCCC dhe Marrëveshjes së Parisit, vlerësoi potencialin e eficiencës së energjisë për të reduktuar emetimet e gazeve serrë në nivel kombëtar, dhe përfundoi vlerësimin e gjendjes së zbatimit të dokumenteve strategjike kombëtare aktuale lidhur me ndryshimet klimatike dhe eficiencën e energjisë, së bashku me gjendjen e tyre të përafritimit. Kjo u arrit nëpërmjet (i) zhvillimit të kornizave strategjike për sektorin e ndryshimeve klimatike në Shqipëri, dhe (ii) ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të Qeverisë së Shqipërisë.

Objektivat e Projektit

Objektivi i këtij projekti ishte mbështetja e

- Zhvillimit ose përmirësimin të kornizave strategjike për të adresuar boshllëqet politike, për të rritur ekspertizën sektoriale dhe për të përmirësuar mjedisin për programimin e GCF-së në investimet me emetim të ulët;
- Krijimi i kapaciteteve, sistemeve dhe rrjeteve adekuate për aktorët përkatës të vendit për të mbështetur planifikimin, programimin dhe zbatimin e aktiviteteve të financuara nga GCF.

Produktet

- Pyetësor për mbledhje të të dhënave;
- Databazë me të dhëna mbi energjinë, në anglisht dhe shqip;
- Raport mbi të dhënat e energjisë; në anglisht dhe shqip;
- Raport mbi analizën e gjendjes së zbatimit të KKP-së ekzistuese 2016-2030 dhe të dokumenteve të zhvillimit sektorial të eficiencës së energjisë, me rekomandime politikash mbi eficiencën e energjisë, në anglisht dhe shqip;
- Udhëzues mbi integrimin gjinor në procesin e ndryshimeve klimatike në Shqipëri, në anglisht dhe shqip;
- Raport mbi potencialin e eficiencës së energjisë për të përmirësuar KKP-në 2021-2030, me rekomandime politikash, analizë të nevojave specifike gjinore dhe të kontributeve të palëve të interesit;
- Manual mbi monitorimin dhe përditësimin e KKP-së, duke identifikuar mësimet e nxjerra nga procesi i përgatitjes dhe përmirësimin të KKP 2016-2030 dhe KKP 2021-2030, dhe duke ofruar rekomandime për një sistem monitorimi;
- Program për ngritjen e kapaciteteve me materiale trajnimi.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

Green Climate Fund (GCF)

PARTNERËT:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)

KOHËZGJATJA:

06/10/2020 - 15/01/2022

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tirana, Albania

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

